



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:180532

Datë: 08.11.2024

Numri i dokumentit: 06425180

PKR.nr.581/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, në përbërje nga gjyqtarja Sulltane Hoti, kryetare e trupit gjykues dhe gjyqtarëve profesionist Alban Ajvazi dhe Avni Sylja, anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arxhenita Vokshi, në çështjen penale ndaj të akuzuarit P.Z për shkak të veprës penale, Falsifikimi i parasë nga neni 296 par.2 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Krimeve të Rënda PP.I.nr.517/2021 të datës 28.09.2021, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor publik, të mbajtur me datë 31.10.2024, në prezencën e përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Prokurorit të Shtetit Arben Hoti, të akuzuarit P.Z me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av.H.M , me datë 05.11.2024 mori dhe shpalli, ndërsa me datë 08.11.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

P.Z nga i ati ... dhe nënës ..., e gjinisë ..., i lindur më ... në fshatin, me vendbanim në rr: ..., përmball amdasadës së ..., me numër personal ..., student, i gjendjes së dobët ekomonike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 21.04.2021, në rrugën “Agim Ramadani” në Prishtinë, i akuzuari P.Z ka vë në qarkullim-deponuar mjetet e tija personale në vlerë prej 350 € (treqind e pesëdhjetë euro) në shtatë kartmonedha në vlerë me nga 50€ (pesëdhjetë euro), të gjitha me një numer serik:MB6666888880 në filialen e bankës “Teb”, e të cilat mjete janë konstatuar nga Banka si të dyshuara për falsifikim dhe të njëjtat sipas Raportit të Agjencionit të Forenzikës me numer serik AKF/2021-1412/2021-1307 të datës 01.06.2021, kanë rezultuar të jenë falsifikim i plotë,-

-me këtë ka kryer veprën penale, Falsifikimi i parasë nga neni 296 par.2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve të lartcekura dhe neneve 4; 7; 17; 21; 38; 39; 43; 44; 69; 70; 71 dhe 72 të KPRK-së dhe neneve 242; 322 par.1, nenit 364, 365 të KPPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

**DËNIM ME BURGIM I CILI ME PËLQIMIN E TË PANDEHURIT I ZËVENDËSOHET ME
DËNIM ME GJOBË**

Të akuzuarit **P.Z** i shqipton Dënim me Burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit i zëvendësohet me Dënim me Gjobë në shumë prej **1500€ (njëmijë e pesëqind Euro)**, të cilën shumë i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin e shqiptuar me gjobë, gjykata konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, të njëjtin do t'i zëvendësojë me dënim me burgim duke llogaritur çdo 20 (njëzet) Euro me një ditë burgim.

Obligohet i akuzuari që t'i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale aq sa do të llogariten sipas shpenzimeve përfundimtare të gjykatës dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumë prej njëqind Euro (**100€**), kurse në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej pesëdhjetë Euro (**50€**), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në mbështetje të nenit 276 par.2 nënpar.2.5 të KPPRK-së, si dhe nenit 296 par.6 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ndaj të akuzuarve urdhërohet: Konfiskimi i sendeve dhe atë: Shtatë (7) Kartëmonedha të falsifikuara në shumë me nga pesëdhjetë (50) euro, numër serik të njëjtë si në vijim: MB6666888880.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, me aktakuzën PP.I.nr.517/2021 të datës 28.09.2021, ka akuzuar P.Z për shkak të veprës penale, Falsifikimi i parasë nga neni 296 par.2 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 31.10.2024 në këtë çështje penale, në të cilën seancë kanë prezantuar Prokurori i shtetit Arben Hoti, i akuzuari P.Z me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av. H.M .

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, të akuzuarit iu dha mundësia e deklaramentit të tij lidhur me fajësinë, ku i akuzuari P.Z ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe nuk ka nevojë për sqarime shtesë, dhe në pyetjen e gjykatës se a e ndien veten fajtor, i njëjti ka deklaruar se e ndien veten fajtor për veprën penale e cila i vihet në barrë, shtoi se e pranon fajësinë për veprën penale, këtë pranim e bëri me vullnet të plotë, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij dhe pa presion dhe i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, shprehi keqardhje për rastin dhe i premtoj gjykatës që nuk do të përsëris sjellje të tilla dhe në fund i propozoj gjykatës që t'i shqiptojë një dënim sa me të butë.

Mbrojtësi i të akuzuarit av.H.M deklaroi se pas konsultimeve të mjaftueshme me të mbrojturin e tij, pa lajthim, pa mashtrim, apo premtim e pranoi fajësinë, kjo aktakuzë nuk përmban ndonjë shkelje ligjore apo faktike, ka kuptuar natyrën dhe pasojat dhe kërkoj nga Gjykata që t'i

mundësojë rrethanat lehtësuese posaçërisht për faktin sepse është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, dhe se i njëjti i premtoj gjykatës se nuk do të përsëritë më veprimet të njëjta apo të ngjashme në të ardhmen.

Prokurori i shtetit deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale e cila i vihet në barrë, i propozoj gjykatës që pranimin e fajësisë ta aprovojë sepse i njëjti është në harmoni me ligjin dhe është dhënë me vullnet të plotë, ky pranim gjen mbështetje edhe në shkresat që gjenden në lëndë, i propozoj gjykatës që pranimin e fajësisë ta aprovojë si të bazuar.

Pas deklarimit të të akuzuarit se ndihet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet nga Prokuroria dhe pas marrjes së mendimit lidhur me pranimin e fajësisë nga Prokurori shtetit dhe mbrojtësi i të akuzuarit, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i akuzuari pasi që është bindur plotësisht se ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë është bërë pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij.

Nga pranimi i fajësisë në mënyrë të plotë dhe të vullnetshme nga i akuzuari P.Z për shkak të veprës penale Falsifikimi i parasë nga neni 296 par.2 të KPRK-së, gjykata konform nenit 322 par.1 lidhur me nenin 242 par.6 të KPPRK-së, në seancën e shqyrtimit gjyqësor, dhe pas marrjes së mendimit nga Prokurori i shtetit dhe mbrojtësit së të akuzuarit, me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë të akuzuarit, pasi që është bindur plotësisht se i akuzuari pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij dhe vazhdoi shqyrtimin gjyqësor me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se meqenëse Gjykata aprovoj pranimin e fajësisë tani më gjendja faktike konsiderohet e vërtetuar dhe gjykatës i propozoj se me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë të dënimit ndaj të akuzuarit pranimin e fajësisë ta pranoj si rrethanë lehtësuese krahas edhe rrethanave të tjera të mundshme qofshin ato lehtësuese apo renduese dhe të njëjti t'i shqiptoj dënim sipas ligjit.

Mbrojtësi i të akuzuarit av.H.M në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se meqenëse i mbrojturi i tij e ka pranuar fajësinë, shkaqet dhe pasojat e kësaj vepre penale, janë minimalisht të dëmshme, vlera e qarkullimit të këtyre parave nuk është e një sasive të madhe andaj e luti gjykatën se me rastin e shqiptimit të dënimit llojit dhe lartësisë së tij, edhe pse ligjvënësi ka paraparë një sanksion bukur të rëndë por duke shfrytëzuar të drejtën mbi benefitet ligjore që instituti i pranimit të fajësisë ndërthen në vete, jeta e mëparshme e të mbrojturit të tij, në kohën e kryerjes ka qenë student e tani është i punësuar dhe efektet ligjore si preventiv vetëm janë arritur, pasi që P.Z që 3 vite ka qenë nën stresin se si do përfundoj kjo çështje dhe si do të marr epilog. Andaj, i propozoj gjykatës që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, të zbutë dënimin duke aplikuar nenet 38, 69, 71 dhe 72 posaçërisht 72, dhe lidhur me nenin 44 me propozimin që gjykata ndaj të njëjtit të shqiptojë një dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 muajve dhe me kërkesën dhe propozimin e të akuzuarit ky dënim të zëvendësohet me gjobë.

I akuzuari P.Z në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se e përkrah në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, edhe njëherë kërkoi ndjesë për rastin dhe premtoi gjykatës se nuk do të përsërisë veprime të tilla apo të ngjashme në të ardhmen.

Nisur nga fakti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihej në barrë, gjykata nuk administroi prova, konstatoi gjendjen faktike si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, nxjerri konkluzion të drejtë dhe të ligjshëm dhe vlerësoi se në veprimet e të akuzuarit, formësohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprës penale, Falsifikimi i parasë nga neni 296 par.2 të KPRK-së, e të cilën vepër penale i akuzuari e ka kryer me dashje, andaj të njëjtin e shpalli fajtor, pasi që gjeti se më parë është penalisht i përgjegjshëm dhe e gjykoj si në dispozitivin e këtij aktgjykimi dhe se nuk ekzistojnë rrethanat të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale të tij.

Gjykata, rikujton se sipas nenit 22 të KPRK-së, dashja është element subjektiv i veprës penale e cila mund të nxjerrët nga rrethanat faktike të rastit. E nga rrethanat e rastit konkret dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, po ashtu bazuar edhe në shkresat e lëndës kemi arritur në përfundim se i akuzuari i lartcekur, veprën e lartcekur penale, e ka kryer me dashje të drejtpërdrejtë apo dashje direkte.

Po ashtu nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë: Raporti i ekspertimit i lëshuar nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë AKF/2021-1412/2021-1307 i datës 01.06.2021; Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve për P.Z ; fotodokumentacioni të parave të fotografuara nga 7 kartmonedha nga 50 euro me të njëjtën shifer-numer serik; Qarkullimi banker I të akuzuarit në banken “Teb” për periudhen 29.12.2019 deri me datë 15.08.2021; Qarkullimi I llogarisë bankare në “NLB Bank” nga data 01.08.2020 deri me adët 23.08.2021; Kontarta e punës-Shoqëria “O.T Capital” L.L.C, dhe njoftimi për dorëheqje nga e njëjta kompani me datë 31.05.2021; Transaksionet bankare “NLB Bank” , si dhe nga shkresat tjera të cilat gjenden në dosjen e kësaj lënde, gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit formësohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprës penale të lartcekur. Andaj, gjykata të njëjtin e shpalli fajtor, pasi që gjeti se penalisht është i përgjegjshëm dhe e gjykoj si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit gjykata mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në pajtim me nenin 69 të KPRK-së, ku si rrethana lehtësuese për të akuzuarin mori pranimin e fajësisë, gjendjen e tij ekonomike, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti, dhe se pas verifikimit në Sistem SEP për të njëjtin nuk është gjetur ndonjë lëndë e plotfuqishme, andaj duke u nisur nga të gjitha këto gjykata me rastin e vendosjes lidhur me sanksionin penal të akuzuarit i shqiptoi dënimin si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, dhe atë dënim me burgim 6 muaj e të cilin dënim me pëlqimin e të akuzuarit i ka zëvendësuar në dënim me gjobë si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me këtë dënim do të arrihet edhe qëllimi i dënimit, i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, që të parandalojë kryesit nga kryerja e veprës penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi është në proporcion me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesve sipas nenit 69 par.2 të KPRK-së, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesve, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesve, si dhe do të ndikoj te të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 pika 2.6 dhe 2.9 të KPRK-së.

Vendimi për shumën e të hollave në emër të taksës për Programin e Kompensimit e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3, nënpar.3.2 të Ligji nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për konfiskimin e parave është marrë konform nenit 296 par.6 të KPRK-së si dhe nenit 276 par.2 nënpar.2.5 të KPPRK-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.581/2021 datë 08.11.2024**

**Zyrtare ligjore
Arxhenita Vokshi**

**Kryetarja e trupit gjykues,
Sulltane Hoti**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda tridhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.